



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:053144

Datë: 16.07.2024

Numri i dokumentit: 05944601

KF.nr.598/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULLI, dhe procesmbajtësen Arlinda Hyseni, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Edona Group”, sh.p.k, me seli në Vushtrri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli-shpenzime të transportit, vlerë kontesti 2.435.70€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 27.06.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat Kushtrim Bytyqi dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Xhafer Krasniqi, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Edona Group”, sh.p.k, me seli në Vushtrri.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/23253 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Edona Group”, sh.p.k, me seli në Vushtrri, t’ia kthej shumën prej 2.435.70 €, (dy/mijë/e/katërqind/e/tridhjetë/e/pesë/euro/e/shtatëdhjetë/cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-18253/29.10.2021, të proceduar në ZBD Mitrovicë. me kamatë ligjore 8%, nga data 30.10.2021, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Edona Group”, sh.p.k, me seli në Vushtrri, përmes përfaqësuesit te autorizuar avokat Kushtrim Bytyqi ka paraqitur padinë në Gjykatë me datë 22.03.2022, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/23253, të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit deklaroi se: Mbesim në tërësi si në të theksuarat në padi duke konsideruar se e paditura me anë të aktvendimit të atakuar ka bërë shkeljet ligjore të referuar në padi përkatësisht nenit 33 të KDA lidhur me nenin 123 të UA-11/2009 pasi që paditësi DUD-ave kontestues i ka bashkangjitur dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit, bëjë rregullimin e kërkesë padisë respektivisht aty ku është theksuar fjala ndryshohet e njëjta duhet të jetë anulohet. E paditura ka aprovuar pjesërisht kërkesë padinë e paditësit me ç ‘rast i ka kthyer paditësit mjetet në vlerë prej 6,095.29€ por përsëri nuk ka marrë për bazë çmimin e transaksionit por ka vepruar në bazë të të dhënave të disponueshme me ç ‘rast baza doganore përsëri ka mbetur e rivlerësuar dhe si rrjedhojë detyrim i paditësit për shkak të rivlerësimit edhe pjesa prej 2,435.70 €. Paditësi konsiderojmë se ka prezantuar para të paditurës të gjitha dokumentet për të vërtetuar çmimin e transaksionit ndaj të cilave e paditura nuk ka dhënë vërejtje mirëpo duke iu referuar në të dhënat e disponueshme ka refuzuar një pjesë të kërkesës. Dokumentet e transaksionit janë elaboruar më në detaje në pikën 2.4 të padisë dhe ndërlidhja e tyre në mes vete duke përfshirë këtu edhe DUD-in jo kontestues R-14977/04.09.2021 me të cilin është deklaruar mall i njëjtë nga paditësi dhe i është pranuar vlera nga e paditura, i cili mall është porositur njëkohësisht edhe me mallin nga DUD-i kontestues. E paditura konsiderojmë se ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike kur ka bërë krahasimin e çmimit me mallrat referente sepse siç mund të shihet nga shkresat e lëndës ndryshon prodhuesi i tyre. Dukë marrë për bazë të theksuarat dhe provat e administruara i propozoj gjykatës që të aprovoj kërkesë padinë e paditësit në tërësi të bazuar, ashtu që të anulohet pjesërisht aktvendimin e atakuar në pjesën refuzuese dhe të obligoj të paditurën që ti kthejë paditësit mjetet në vlerë prej 2,435.70 euro në kamat prej 8% nga data 30.10.2021 e deri në kthimin e plotë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 18.10.2022 e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, dhe se vendimi i atakuar me padi është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka

mbështetur me prova materiale. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit deklaron se: Kundërshtojmë padinë dhe kërkesë padinë e paditësit dhe i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Pretendimet e paditësit janë të pabazuara për arsye se edhe në referatin e padisë paditësi ka pretenduar se nuk i është aprovuar ankesa në tërësi por vetëm për bazë doganore dhe jo edhe për shpenzimet e transportit andaj pretendimi i paditësit të shprehura gjatë kësaj seance duhet të konsiderohet i pa bazë sepse e paditura i ka aprovuar pjesërisht ankesën sa i përket vlerës së mallit, mirëpo nuk i ka aprovuar pretendimet e paditësit për shpenzimet e transportit. Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi ka sjell mallin nga shteti i Shri Lanka dhe të deklaruara në dy kontejnerë të tipit 40 që nënkupton që janë të madhësisë më të lartë, andaj edhe në kuptim të Udhëzimit Administrativ dhe në vështrim të nenit 4 për transport detar, paditësi nuk mund të vërtetojë bazën juridike të kërkesë padisë sepse në aneksin 2 të Udhëzimit Administrativ numër 4/2014 për transport detar nga shteti Shri Lanka janë të paraparë shpenzimet më të larta të transportit. Andaj, konsiderojmë se pretendimet e paditësit për rivlerësim të mallit janë jo lëndore, pasi që me aktvendimin e atakuar i është aprovuar pjesërisht ankesa dhe i janë kthyer mjetet. Sa i përket vlerës së kontestit si kërkesë e paditësit në kuptim të lartësisë e njëjta është e saktë por ne konsiderojmë se nuk ka bazë juridike që e njëjta ti kthehet paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 20.06.2024, ka administruar provat dhe atë: aktvendimi 01.3.2.2/23253 i datës 22.02.2022, DUD 18253/29.10.2021 me MV1 dhe MV6, deklarata EX1 e datës 02.09.2021, proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, pagesa e detyrimeve doganore e datës 30.10.2021, Përgjigja në padi e datës 18.10.2022, Urdhër kthimi i mjeteve, Ankesa e ushtruar në Doganë, e-mail korrespondenca e datës 26.01.2022, të dhënat nga Reuters, Pro-faturat nr..PF-591-1-21, nr.PF-630-21, pagesat bankare ndërkombëtare të datës 14.06.2021, 17.08.2021 dhe 19.10.2022, fatura nr.EIN2021/00126, nr.EIN2021/00126/A, fatura e shpenzimeve të transportit detar nr.EXPIN243060921 së bashku me faturën me nr.EIN2021/00126 në versionin me paritet FOB, DUD-i 14977/04.09.2021, 17285/15.10.2021, 27364/22.09.2021, 14977/04.09.2021, 14518/30.08.2021 së bashku me faturat e mallit.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur

edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se këtu subjekti “Edona Group”, sh.p.k, me seli në Vushtrri., këtu paditësi përmes DUD-it nr. R-18253/29.10.2021, të proceduar në ZBD Mitrovicë, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit me paritet CIF Durrës. Po ashtu, nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që e paditura e ka kontestuar vlerën e mallit dhe paritetin CIF, e ku si rezultat i kësaj përmes procesit ka rivlerësuar mallin dhe shpenzimet e transportit sipas vendimit të qeverisë nr. 17/36 të datës 22.09.2021. Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës e për të cilën ankesë e paditura, ka sjell aktvendimin kontestues me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e këtu paditësit, duke aprovuar si të bazuar vlerën e mallit, por ka lënë në fuqi vendimin DUD-in kontestues lidhur me shpenzimet e transportit, e ndaj të cilin aktvendim paditësi me këtë padi ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vlerës së mallit ku është pranuar baza doganore e mallit por jo edhe e shpenzimeve të transportit. Tutje e paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se subjekti këtu paditësi nuk i ka paraqitur saktë shpenzimet e transportit, pra në DUD-in R-18253/29.10.2021 është deklaruar pariteti CIF Durrës, ndërsa të njëjtin paritet nuk e ka mbështetur edhe me dokumentacion përcjellës.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit i pariteti i deklaruar CIF Durrës e i cili ka mbështetje në faturën nr. EIN2021/00126, pro-faturën nr. PF630-21, dhe kontratën PF630-21, nuk është paritet real i paguar i mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështirë të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se e paditura do të mund ta mbështeste një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit vetëm çmimin neto të faturës të mallit pa përfshirë edhe shpenzimet e transportit detar deri në Durrës/Shqipëri, ku vlera e mallit të faturuar me faturën nr. EIN2021/00126, pro-faturën nr. PF630-21, dhe kontratën PF630-21, nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes Urdhërpagesave Ndërkombëtare me status të aprovuar të datës:

14.06.2021, 17.08.2021 dhe 19.10.2022, në emër të mallit me paritet CIF Durrës dhe e cila pagesë është në harmoni të plotë në kuptim të shumës dhe përfituesit si në faturë, pro-faturë dhe kontratë.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për kontestim të shpenzimeve të transportit dhe caktim të bazës së re doganore duke ndryshuar edhe paritetin e mallit për paditësin, fakti që e në periudhën kontestuese transporti detar i mallit ka pësuar ndryshime, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK- shprehimisht përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjete tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturën e mallit lëndor EIN2021/00126, pro-faturën nr. PF630-21, dhe kontratën PF630-21 nga eksportuesi me vlerë të mallit dhe me paritet CIF Durrës dhe e njëjta është paguar nga paditësi përmes Urdhërpaguesave Ndërkombëtare me status të aprovuar të datës: 14.06.2021, 17.08.2021 dhe 19.10.2022, dhe të cilat janë në harmoni të plotë edhe në kuptim të shumës si në faturë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së, vlerë kjo e cila përfshin edhe shpenzimet e transportit siç është përcaktuar me nenin 36, paragrafi 1, pika (e), (i), e KDAK-së.

Prandaj, nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor me paritet CIF Durrës, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, gjykata miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'ia kthej shumën prej 2.435.70 €, (dy/mijë/e/katërqind/e/tridhjetë/e/pesë/euro/e/shtatëdhjetë/cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-18253/29.10.2021.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, si pasojë e rivlerësimit të mallit në emër të shpenzimeve të transportit nuk u kontestua në kuptim të lartësisë as nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur i cili në seancën e datës 27.06.2024, deklaroi se : *“Sa i përket vlerës se kontestit si kërkesë e paditësit në kuptim të lartësisë, e njëjta është e saktë por ne konsiderojmë se nuk ka bazë juridike që e njëjta ti kthehet paditësit”*.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Për kamatën Gjykata ka vendos duke u mbështetur në dispozitat e KDAK-së, Kodi Nr. 03/L-109, neni 292, pika b), *“Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: ((b) Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”*, në rastin konkret e njëjta është e aplikueshme ngase këtu paditësi e ka parashtruar si kërkesë dhe në nenet 378 dhe 382 të LMD-së, ndërsa si moment të fillimit të kamatës e në bazë të dëshmisë së pagesës bankare të detyrimeve doganore të paguara më tepër mori datën e pagesës bankare së detyrimeve doganore 30.10.2021.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.589/22 datë 27.06.2024

Procesmbajtëse
Arlinda HYSENI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.